



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1631/1 Prot

Tiranë, më 05.12.2019

V E N D I M

Nr.153, datë 05.12.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Has, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit”, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Has,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në shërbimin civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Has.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Has, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe

organikës të miratuar me vendimin nr. 02, datë 03.01.2019, të Kryetarit të Bashkisë Has, “Për miratimin e strukturës, organikës, së Bashkisë Has, për vitin 2019” dhe në bazë të vendimit nr. 78, datë 26.02.2019, të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Has, për vitin 2019”, strukturë e cila është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Has së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **44** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **1** pozicion i nivelit të lartë drejtues, **1** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **9** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **33** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Në strukturën organizative të Bashkisë Has konstatohet se në disa raste (*në Njësi Administrative*), ndarja e pozicioneve të punës në nëpunës civilë dhe funksione ndihmëse administrative, nuk është realizuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil, pasi disa pozicione pune të cilat kanë karakteristikat dhe janë trajtuar si pjesë e shërbimit civil, në mënyrë të parregullt dhe pa asnjë analizë ligjore, iu janë bashkëngjitur emërtesa dhe detyra që kanë të bëjnë me pozicione pune që kryejnë veprimtari ndihmëse/administrative.

Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, me miratimin e strukturës së ardhshme të institucionit, njësia përgjegjëse duhet të përcaktojë qartë pozicionet e shërbimit civil, duke i ndarë nga pozicionet që do të kryejnë funksione politike dhe nga pozicionet që nuk ushtrojnë funksion publik (*punonjësit administrativë*), dhe t’i përshtatë detyrat, funksionet dhe emërtesat e pozicioneve të shërbimit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 19, të ligjit për shërbimin civil, si dhe me ligjet që rregullojnë çdo sektor të veprimtarisë së bashkisë.

Njëkohësisht, Komisioneri konstaton një qëndrim jo të unifikuar ndaj pozicioneve të shërbimit civil, që janë pjesë e strukturës së njësite administrative. Konkretisht, konstatohet se, pozicionet e punës me funksionet e ndihmës ekonomike si dhe të emergjencave civile, pranë njësite administrative, në disa raste paraqiten me emërtesën “*Specialist i ndihmës ekonomike/Specialist i emergjencave civile*” dhe në raste të tjera, paraqiten me emërtesën “*Punonjës i ndihmës ekonomike/Punonjës i emergjencave civile*”.

Në lidhje me këtë problematikë, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Has në momentin e miratimit të strukturës së ardhshme të institucionit, për pozicionet e punës që janë pjesë e strukturës së njësite administrative (*Fajza, Gjinaj dhe Golaj*), duhet të analizojë detyrat dhe kompetencat e tyre dhe në përfundim të këtij procesi të vendosë përfshirjen e këtyre pozicioneve ose jo, në skemën e shërbimit civil.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt u konstatua se, **11** pozicione pune të shërbimit civil, janë plotësuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **33** pozicione të shërbimit civil, rezultojnë të plotësuara me punonjës të punësuar me akt të përkohshëm emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jo sipas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, ose nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit drejtues.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. *****, Sekretar i Përgjithshëm, në Bashkinë Has, emëruar me urdhrin nr. 543, datë 06.08.2019.
2. *****, “*Specialist finance*”, në Sektorin e Ekonomik, emëruar me urdhrin nr. 779, datë 18.12.2018;
3. *****, “*Specialist finance*”, në Sektorin e Ekonomik, emëruar me urdhrin nr. 29, datë 12.08.2015;
4. *****, “*Specialist finance*”, në Sektorin e Ekonomik, emëruar me urdhrin nr. 87, datë 29.02.2016;
5. *****, “*Inspektor i ndihmës ekonomike*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore, emëruar me urdhrin nr. 446, datë 16.07.2018;
6. *****, “*Inspektor i ndihmës ekonomike*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore, emëruar me urdhrin nr. 87/5, datë 29.02.2016;
7. *****, “*Përgjegjës i Sektori të Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës*”, emëruar me urdhrin nr. 22, datë 19.05.2014;
8. *****, “*Inspektor i pronave*”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, emëruar me urdhrin nr. 56/3, datë 12.05.2015;
9. *****, “*Inspektor territori*”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, emëruar me urdhrin nr. 748, datë 07.12.2018;
10. *****, “*Inspektor i emergjencave*”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, emëruar me urdhrin nr. 87/4, datë 29.02.2016;
11. *****, “*Inspektor i emergjencave*”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, emëruar me urdhrin nr. 599/1, datë 30.08.2019;
12. *****, “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e M. M. Tokave dhe Mbrojtjes së Konumatorit, emëruar me urdhrin nr. 587, datë 01.10.2018;
13. *****, “*Inspektor i kontrollit blegtoral dhe ushqimore*”, në Sektorin e M.M.Tokave dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, emëruar me urdhrin nr. 522, datë 27.08.2018;
14. *****, “*Specialist kadastrë*”, në Sektorin e M. M. Tokave dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, emëruar me urdhrin nr. 539, datë 31.08.2018;

15. ***** , “*Inspektor për taksa dhe tarifa*”, në Sektorin e Taksave dhe Tarifave, emëruar me urdhrin nr. 33/1, datë 02.08.2011 (*sipas vendimit paralajmërues të Komisionerit, ky punonjës rezulton me arsim të mesëm*);
16. ***** , “*Inspektor për taksa dhe tarifa*”, në Sektorin e Taksave dhe Tarifave, emëruar me urdhrin nr. 416, datë 18.10.2017;
17. ***** , “*Inspektor arkivi*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, emëruar me urdhrin nr. 21, datë 13.07.2011 (*sipas vendimit paralajmërues të Komisionerit, kjo punonjëse nuk zotëron diplomë sipas kërkesave të pozicionit të punës ku aktualisht ushtron detyrën*);
18. ***** , “*Inspektor arsimit*”, në Sektorin e Arsimit dhe Kulturës, emëruar me urdhrin nr. 253, datë 07.06.2017;
19. ***** , “*Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Publike*”, emëruar me urdhrin nr. 109, datë 30.03.2016;
20. ***** , “*Specialist finance – arkivi*”, në Njësinë Administrative Golaj, emëruar me kontratë individuale pune datë 01.01.2014 (*sipas vendimit paralajmërues të Komisionerit, kjo nëpunëse rezulton me arsim të mesëm*);
21. ***** , “*Inspektor territori*”, në Njësinë Administrative Golaj, emëruar me urdhrin nr. 84, datë 29.02.2016;
22. ***** , “*Inspektor i emergjencave civile*”, në Njësinë Administrative Golaj, emëruar me urdhrin nr. 623, datë 12.10.2018;
23. ***** , “*Inspektor shërbimesh*”, në Njësinë Administrative Golaj, emëruar me urdhrin nr. 26, datë 12.08.2015;
24. ***** , “*Specialist finance – arkivi*”, në Njësinë Administrative Fajza, emëruar me urdhrin nr. 540, datë 01.08.2018;
25. ***** , “*Punonjës i ndihmës ekonomike*”, në Njësinë Administrative Fajza, emëruar me urdhrin nr. 106/3, datë 13.03.2017;
26. ***** , “*Inspektor bujqësie*”, në Njësinë Administrative Fajza, emëruar me urdhrin nr. 230, datë 10.04.2019;
27. ***** , “*Specialist finance – arkivi*”, në Njësinë Administrative Gjinaj, emëruar me urdhrin nr. 444, datë 14.11.2017;
28. ***** , “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, në Njësinë Administrative Gjinaj, emëruar me urdhrin nr. 18, datë 13.01.2017;
29. ***** , “*Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve*”, emëruar me urdhrin nr. 59, datë 27.01.2016;
30. ***** , “*Përgjegjës Sektori*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, emëruar me urdhrin nr. 60, datë 29.01.2016;
31. ***** , “*Specialist i pyjeve dhe kullotave*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, emëruar me urdhrin nr. 75, datë 29.02.2016;
32. ***** , “*Specialist i kadastrës dhe GIS*”, emëruar në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve me urdhrin nr. 61, datë 29.01.2016;

33. *****, “*Specialist*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, emëruar me urdhrin nr. 170, datë 18.03.2019.

Komisioneri evidenton se, aktet e mësipërme të emërimit, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht, kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me këtë rregull, në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, është absolutisht i pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën për pozicionet e nivelit ekzekutiv, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Has, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe në bazë të pikës 1, të nenit 111, të po këtij ligji, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “*Pranimi në shërbim civil*”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*” dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në*

detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Has, të konstatojë menjëherë, si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, **33** aktet e emërimit të punonjësve të mëposhtëm:

- ✓ *****, Sekretar i Përgjithshëm, në Bashkinë Has, emëruar me urdhrin nr. 543, datë 06.08.2019.
- ✓ *****, “Specialist finance”, në Sektorin e Ekonomik, emëruar me urdhrin nr. 779, datë 18.12.2018;
- ✓ *****, “Specialist finance”, në Sektorin e Ekonomik, emëruar me urdhrin nr. 29, datë 12.08.2015;
- ✓ *****, “Specialist finance”, në Sektorin e Ekonomik, emëruar me urdhrin nr. 87, datë 29.02.2016;
- ✓ *****, “Inspektor i ndihmës ekonomike”, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore, emëruar me urdhrin nr. 446, datë 16.07.2018;
- ✓ *****, “Inspektor i ndihmës ekonomike”, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore, emëruar me urdhrin nr. 87/5, datë 29.02.2016;
- ✓ *****, “Përgjegjës i Sektori të Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës”, emëruar me urdhrin nr. 22, datë 19.05.2014;
- ✓ *****, “Inspektor i pronave”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, emëruar me urdhrin nr. 56/3, datë 12.05.2015;
- ✓ *****, “Inspektor territori”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, emëruar me urdhrin nr. 748, datë 07.12.2018;
- ✓ *****, “Inspektor i emergjencave”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, emëruar me urdhrin nr. 87/4, datë 29.02.2016;
- ✓ *****, “Inspektor i emergjencave”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, emëruar me urdhrin nr. 599/1, datë 30.08.2019;

- ✓ ***** , “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e M. M. Tokave dhe Mbrojtjes së Konumatorit, emëruar me urdhrin nr. 587, datë 01.10.2018;
- ✓ ***** , “Inspektor i kontrollit blegtoral dhe ushqimore”, në Sektorin e M.M.Tokave dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, emëruar me urdhrin nr. 522, datë 27.08.2018;
- ✓ ***** , “Specialist kadastrë”, në Sektorin e M. M. Tokave dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, emëruar me urdhrin nr. 539, datë 31.08.2018;
- ✓ ***** , “Inspektor për taksa dhe tarifa”, në Sektorin e Taksave dhe Tarifave, emëruar me urdhrin nr. 33/1, datë 02.08.2011;
- ✓ ***** , “Inspektor për taksa dhe tarifa”, në Sektorin e Taksave dhe Tarifave, emëruar me urdhrin nr. 416, datë 18.10.2017;
- ✓ ***** , “Inspektor arkivi”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, emëruar me urdhrin nr. 21, datë 13.07.2011;
- ✓ ***** , “Inspektor arsimit”, në Sektorin e Arsimit dhe Kulturës, emëruar me urdhrin nr. 253, datë 07.06.2017;
- ✓ ***** , “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Publike”, emëruar me urdhrin nr. 109, datë 30.03.2016;
- ✓ ***** , “Specialist finance – arkivi”, në Njësinë Administrative Golaj, emëruar me kontratë individuale pune datë 01.01.2014;
- ✓ ***** , “Inspektor territori”, në Njësinë Administrative Golaj, emëruar me urdhrin nr. 84, datë 29.02.2016;
- ✓ ***** , “Inspektor i emergjencave civile”, në Njësinë Administrative Golaj, emëruar me urdhrin nr. 623, datë 12.10.2018;
- ✓ ***** , “Inspektor shërbimesh”, në Njësinë Administrative Golaj, emëruar me urdhrin nr. 26, datë 12.08.2015;
- ✓ ***** , “Specialist finance – arkivi”, në Njësinë Administrative Fajza, emëruar me urdhrin nr. 540, datë 01.08.2018;
- ✓ ***** , “Punonjës i ndihmës ekonomike”, në Njësinë Administrative Fajza, emëruar me urdhrin nr. 106/3, datë 13.03.2017;
- ✓ ***** , “Inspektor bujqësi”, në Njësinë Administrative Fajza, emëruar me urdhrin nr. 230, datë 10.04.2019;
- ✓ ***** , “Specialist finance – arkivi”, në Njësinë Administrative Gjinaj, emëruar me urdhrin nr. 444, datë 14.11.2017;
- ✓ ***** , “Specialist i ndihmës ekonomike”, në Njësinë Administrative Gjinaj, emëruar me urdhrin nr. 18, datë 13.01.2017;
- ✓ ***** , “Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve”, emëruar me urdhrin nr. 59, datë 27.01.2016;
- ✓ ***** , “Përgjegjës Sektori”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, emëruar me urdhrin nr. 60, datë 29.01.2016;
- ✓ ***** , “Specialist i pyjeve dhe kullotave”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, emëruar me urdhrin nr. 75, datë 29.02.2016;

- ✓ *****, “*Specialist i kadastrës dhe GIS*”, emëruar në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve me urdhrin nr. 61, datë 29.01.2016;
- ✓ *****, “*Specialist*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, emëruar me urdhrin nr. 170, datë 18.03.2019,

dhe të rregullojë pasojat, duke i shpallur këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

2. Njësia përgjegjëse, për pozicionet e shërbimit civil, të cilat në kuptim të ligjit aktualisht janë vakante ose rezultojnë të plotësuara në kundërshtim me ligjin, të shpallë konkurrimin për t’i plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit paralajmërues të Komisionerit dhe më tej, të vijojë realizimi i procedurave të konkurrimit.
3. Institucioni të përgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”.
4. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Has, në momentin e miratimit të strukturës së ardhshme për vitin 2020, të tregoj kujdes në krijimin e një strukture, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke vepruar si më poshtë:
 - ✓ Të përcaktojë qartë pozicionet e shërbimit civil, duke i ndarë nga pozicionet që do kryejnë funksione politike dhe administrative, duke përshtatur detyrat, funksionet dhe emërtesat e pozicioneve të shërbimit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar; vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, si dhe me ligjet që rregullojnë çdo sektor të veprimtarisë së bashkisë.
 - ✓ Për pozicionet e punës pjesë e strukturës organizative të njësive administrative, të cilat kryejnë funksionet e ndihmës ekonomike dhe të emergjencave civile dhe në strukturën aktuale paraqiten me emërtesën “*Specialist i ndihmës ekonomike/Specialist i emergjencave civile*” dhe “*Punonjës i ndihmës ekonomike/Punonjës i emergjencave civile*”, të analizojë detyrat, funksionet dhe kompetencat përkatëse, nëpërmjet procesit të hartimit të përshkrimeve të punës

dhe në përfundim të këtij procesi, të vendosë përfshirjen e këtyre pozicioneve ose jo, në skemën e shërbimit civil.

5. Të përmbillet procesi i mbikëqyrjes, i cili është materializuar me vendimin paralajmërues nr. 86, datë 07.11.2018, të Komisionerit “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Has dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë” dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt sipas dispozitivit të vendimit paralajmërues për këtë institucion.
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 (tre) muaj** nga marrja dizeni për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Has, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Has, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Has, Ministria e Brendshme dhe Prefekti i Qarkut Kukës. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Has të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha